

*Bismil-lahi-rr-Rrahmani-rr-Rrahim*

Çfarë e shtyri AbduRahman Sumejtin që nga një student në studimet e larta në Britani të kalojë në një thirrës të madh afrikan?

Kur të përmendet Afrika patjetër se do të përmendet edhe mjeku dhe thirrësi i madh, AbduRahman Sumejti [Allahu e mëshiroftë!]

Çdo vepër ka motivin përkatës, sikur që çdo projekt ka shtytësin-lëvizësin, por cilët janë motivi dhe shtytësi që qëndrojnë prapa një kontributi dhe sakrifice 24 vjeçare në fushën e thirrjes islame në kontinentin e zi?

Çfarë force e madhe mund të qëndrojë prapa një angazhimi, rezultati i të cilit matet me të arriturat në vijim:

- 11 milionë njerëz e kanë pranuar Islamin
- Janë ndërtuar mbi 5000 xhami
- Janë hapur më shumë se 7000 puse
- Janë themeluar 4 universitete dhe mbi 200 qendra islame
- Janë shpërndarë më shumë se 50 milionë kopje të Kur'anit

...dhe një sërë veprash tjera që mbushin një listë të gjatë.

Thotë Sumejti [Allahu e pastë mëshiruar!]:

*“Gjatë kohës sa isha në Britani për studimet e larta në mjekësi, gjegjësisht në vitin 1978, dëgjova për një konferencë që mbahej në Kolorado, ku ishin tubuar kokat e të devijuarve nën udhëheqjen e Vatikanit...Morën vendim që duhet të punonin shumë në mënyrë që me të ardhur të vitit 2000, pra pas 22 viteve, Afrika të shndërrohej e tëra në kontinent të krishterë. U zotuan për angazhim dhe përpjekje maksimale. Nuk mund ta përmbaja dot veten, andaj jam kthyer në Kuvajt nga ku në vitin 1981 kam udhëtuar për në Afrikë...”*

Që nga ajo kohë, Sumejti [Allahu e pastë mëshiruar!] ngriti flamurin e sfidimit, xhihadit dhe da'ves, që t'i qëndroj përballë Vatikanit, duke ua shkëputur kështu rrugën e realizimit të qëllimeve dhe interesave të tyre.

Allahu e pastë mëshiruar Sumejtin, reagimi i tij ishte si pasojë e komplotit që kishte dëgjuar të thurej për fukaratë e kontinentit të zi.

A nuk kemi dëgjuar edhe ne për komplete të tilla, që kanë paraprirë dhe që kanë pasuar këtë komplot?!

E vërteta është se dëgjimi dallon nga dëgjimi dhe kjo si shkak i dallimit në vullnet dhe vendosmëri, e i cili, rrjedhimisht, nuk ndodhë ndryshe vetëm se si pasojë e dallimit në forcën shpirtërore dhe në lidhjen për botës tjetër, gjegjësisht besimit në shpërblimet dhe ndëshkimet e saj.

Allahu e pastë mëshiruar Ibn El-Xheuzijj që ka thënë: *Njeriu nuk është sprovuar me diç më të madhe se ambicia e lartë.*[\[1\]](#)

Veddah bin Hadi

www.saaid.net

Përktheu: Dr. Sedat Islami

[\[1\]](#)Autori ka mjaftuar me këtë pjesë, ndryshe thënia e Ibn El-Xheuzijj është më e gjatë dhe në të fshihet dhe domethënia që realisht nuk kuptohet drejtë nga kjo pjesë. Ibn El-Xheuzijj synon me thënien e tij mundimin dhe përvëlimin shpirtëror që ndien në njeri me ambicie të larta ndërsa nuk mundet t'i realizojë ato shkak i kohës ose rrethanave dhe mundësive. Përkthyesi: S.I.